



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit

P-129

Prishtinë, më 20 qershor 2013

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 20 QERSHOR 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Kuvendit, Jakup KRASNIQI.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Nait Hasani, Arben Gashi, Visar Ymeri, Time Kadrijaj, Halit Krasniqi, Salih Morina, Alma Lama, Haki Demolli dhe Albana Gashi, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Danush Ademi parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me mundësinë e rishikimit të nenit 4, pika 4.5 të Ligjit për skemën sociale për përfshirjen e familjeve të komunitetit ashkali në kategorinë për ndihma sociale.

Ministri Nenad Rashiq nuk ishte i pranishëm në sallë.

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimin e kryeministrit, që pika **5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë**

normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të shtyhet për një seancë të radhës, si dhe me propozimin e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputetit Ali Sadriu, që pika **6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012** të hiqet nga rendi i ditës.

Kryetari i hodhi në votim formal propozimet e lartpërmendura.

Kuvendi, me shumicë votash, i miratoi propozimet e lartshënuara.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me rirregullimin e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave,
5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2012,
7. Shqyrtimi i kërkesës për transferin e mjeteve nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

* * *

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 6, 7 dhe 13 qershor 2013 pa vërejtje.

4. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me rirregullimin e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2013.

Ai e hodhi në votim miratimin e propozim-rekomandimit të deputetit Ramiz Kelmendi nga debati parlamentar lidhur me rirregullimin e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 44,
Kundër -----13,
Abstenime -----10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi këtë:

REKOMANDIM

Taksa e siguracionit për automjete të udhëtarëve dhe automjeteve për mallra që e kanë destinacion Republikën e Kosovës dhe transitin nëpër të, të rirregullohet në atë mënyrë që shuma e përcaktuar të pjesëtohet për numër të ditëve dhe të jetë shuma ditore e qëndrimit, e shumëzuar për numrin e ditëve që do të qëndrohet.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, dhe Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 57,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012

Deputeti Idriz Vehapi, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deklaroi që ky komision e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012 dhe Kuvendit i rekomandon mosmiratimin e tij.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lirije Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar AAK; Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Milivoje Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’; Jakup Krasniqi, Halit Krasniqi dhe Salih Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 26,
Kundër ----- 33,
Abstenime ----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi raportin vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2012.

7. Shqyrtimi i kërkesës për transferin e mjeteve nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ministri Bajram Rexhepi, në emër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, deklaroi se transferi prej 1 milion eurove në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, konkretisht në Departamentin për Rindërtim e Banim, është kërkuar të bëhet edhe vitin e kaluar me vendimin e Bordit për Implementim për shkak të obligimeve të trashëguara nga viti i kaluar dhe mungesës së mjeteve për ndërtimin, rindërtimin dhe sigurimin e pajisjeve për personat e riatdhesuar.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së; Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar AAK; Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Jasmina Zhivković, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Goran Marinković, emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’; Ardian Gjini dhe Fatmir Xhelili, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, kryetari e hodhi në votim kërkesën për transferin e mjeteve buxhetore.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 53,
Kundër ----- 1,
Abstenime -----15.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për transferin e mjeteve prej 1 000 000 (një milion) euro të projektit kapital “Ndërtimi i shtëpive dhe rehabilitimi i objekteve banesore për personat e riatdhesuar”, nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në nën-programin “Departamenti i banimit dhe ndërtimit”, në kategorinë shpenzime kapitale.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale